REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1682/1/2 Prot.

Vlorë, më 12/10/2026

VENDIM

"Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori - subjekti "SIMAK SHOES" sh.p.k me NUIS L56517201K, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë".

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.106, me Nr.1682/1 Prot., datë 12/06/2026, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 5,605 (pesë mijë e gjashtëqind e pesë) lekë, si dhe penalitetin doganor në masën e trefishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 16,815 (gjashtëmbëdhjetëmijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 258/1/a të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor "SIMAK SHOES" sh.p.k me NUIS L56517201K, me seli në Vlorë (Lagjja "Bashkimi", Rruga "Sado Koshena", Nr.10; Nr. Tel : 0692024399), me status në QKB "Aktiv". Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor "SIMAK SHOES" sh.p.k me NUIS L56517201K me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.1682/2 Prot., datë 17/06/2026, me lëndë "Njoftim Vendimi", por rezulton se zarfi me kod bar RR833845894AA është rikthyer në doganë me shënimin postar "Larguar".

Më tej, Dega e Doganës Vlorë ka vijuar me kryerjen e lajmërimit (njoftimit) publik me shkresat : Nr.2210 Prot., datë 24/07/2026, me "*Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*", drejtuar Bashkisë Vlorë, e cila ka kryer konfirmimin e shpalljes publike me shkresën e saj nr.15393/1 Prot., datë 03/08/2026, me lëndë "Mbi kërkesën për konfirmim të shpalljes publike", e cila është administruar në doganë me nr.2210/1 Prot., datë 10/08/2026;

Nr.2211 Prot., datë 24/07/2026, me "*Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*", drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë, i cili ka kryer konfirmimin e shpalljes publike me shkresën e Tij nr.1072/1 Prot., datë 31/08/2026, me lëndë "Mbi shpalljen publike të aktit administrativ", e cila është administruar në doganë me nr.2480/1/1 Prot., datë 03/09/2026;

Nr.2212 Prot., datë 24/07/2026, me "*Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*", drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, i cili ka kryer afishimin me shkresën nr.14489 Prot., datë 29/07/2026;

Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me njoftimin elektronik të vendimit, me email-in e datës 25/08/2026, ora 09:15, me lëndë "Rinjoftim akti Administrativ (Vendimi Nr.106, me nr.1682/1 Prot., datë 12-06-2026). Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar me shkresën Nr.2553 Prot., datë

25/08/2026 me lëndë "Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me email-in e datës 27/08/2026 me lëndë "Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me shkresën Nr.2553/1 Prot., datë 18/09/2026 me lëndë "Rikërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me email-in e datës 26/09/2026 me lëndë "Rikërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me anë të së cilës, Dega e Doganës Vlorë i ka rikërkuar subjektit debitor ekzekutimin vullnetar edhe të aktit administrativ të lartcituar.

Personi juridik debitor "SIMAK SHOES" sh.p.k me NUIS L56517201K, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.106, me Nr.1682/1 Prot., datë 12/06/2026, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.106, me Nr.1682/1 Prot., datë 12/06/2026, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti "SIMAK SHOES" sh.p.k me NUIS L56517201K, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*,

V E N D O S A :

• Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "SIMAK SHOES" sh.p.k me NUIS L56517201K, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.

• Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "SIMAK SHOES" sh.p.k me NUIS L56517201K, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.

• Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, subjekti "SIMAK SHOES" sh.p.k me NUIS L56517201K, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale **22,420** (Njëzet e dy mijë e katërqind e njëzet) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.106, me Nr.1682/1 Prot., datë 12/06/2026, të Degës së Doganës Vlorë.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj